



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-1990/21
Kaçanik, 25.01.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I-r (Parë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 25 Janar 2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës - Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Festim Neziraj, Zahir Doda dhe Bahri Selimi, ndërkaq nga zyrtarët ishte: Arbnora Kuka.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e I-r (Parë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2021, data 25 Janar, me këtë

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Propozim Rregullorja për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale;
3. Draft Kodi i Etikës;
4. Informatë e Kryesuesit të Kuvendit, për aktivitetin e Kuvendit të Komunës për vitin 2020;
5. Informatë e DAK, për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2020-2021; dhe
6. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021.

Kryesuesi i Kuvendit, Pika e 6 nuk ishte në Ftesën për mbledhje, materiali për këtë pikë iu është dërguar me vonë. Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së XI-të (Njëmbëdhjetë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë: 18.12.2020 /Lënda: 01Nr. 060/01-30882/20.

2. Propozim Rregullorja për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, para se më hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i DAP, Festim Neziraj për sqarime të nevojshme.

z. Festim Neziraj, Kur është ndryshuar dhe plotësuar Statuti i komunës, kemi qenë të obliguar që të bëjmë rregulloren me numrin e drejtorive dhe zyrave, duke ua përshkruar detyrat e punës. Në këtë rregullore janë përfshirë të gjitha drejtoritë, ndërkaq stafi janë këta që janë, pa ndonjë punësim të ri. Drafti ka kaluar procedurën e debatit publik me qytetarë dhe i njëjti pas saj është proceduar në KPF dhe KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me këtë Propozim Rregullorë e hapi diskutimin: Për diskutim, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Rregulloren për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale; dhe e njëjta i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Draft Kodi i Etikës;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Është mirë që po bëhet ky draft, ndërkaq ajo çka vendoset duhet me u zbatuar. Të neni 7 pika 2.2, këmisha pa jakë, pa mëngë dhe me ngjyra të pazakonta, me shikuar këtë pasues, sepse nëse zbatohet kjo dispozitë ligjore, atëherë kujtoj që gjysma e zyrtarëve duhet me shkuar në shtëpi, sepse nuk e di sa mundën t'i përmbahen zbatimit të tij.

z. Ekrem Kyçyku, Unë kam punuar jashtë, dhe e di së ka shtete që me kode ndërkombëtare, nuk lejohet veshja komplet me ngjyrë të zezë. Gjithashtu edhe këmisha pa jaka nuk lejohen të zyrtarët.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë mendoj se duhet me u specifikuar cilat janë ngjyrat e pazakonta.

z. Festim Neziraj, Kur e kanë hartuar draftin zyrtarët ligjor, unë kam qenë në debate që nga fillim dhe ka pasur diskutime për këtë pikë. Ngjyrat e pazakonta janë; ngjyra për meshkujt të cilat nuk shkojnë, si ngjyra portokalli apo me lara, verdhë etj. Se cilat janë ngjyra të pazakonta, janë organet kompetente që i përcaktojnë ato.

Kryetari i Komunës, Është problematike ky pasues të ngjyrat e pazakonta, sepse dikujt i pëlqen me u veshur fjala vjen me ngjyrë të verdhë apo të ngjashme dhe për të ato ngjyra janë të zakonata.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë mendoj së ky pasues duhet me u hequr, ose e përkufizojmë ndryshe. Nuk mundemi ne me dhënë një vlerësim së cilat ngjyra janë të pazakonshme, sepse për dike mundet me qenë një ngjyrë e pazakontë, por për dike tjetër ajo ngjyrë është e zakonit. Diskutime të tjera nuk ka, me ndryshim që pasuesi, ngjyra e pazakonta të hiqet të neni 7 pika 2.2 e shtroj në votim Draft Kodin e Etikës dhe e njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Draft Kodi i Etikës; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Informatë e Kryesuesit të Kuvendit, për aktivitetin e Kuvendit të Komunës për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Në këtë informatë është përfshirë aktiviteti i KK në pika të shkurtër, ka edhe shumë çështje që nuk janë përfshirë, megjithatë është bërë një përmbledhje e aktivitetit të KK. Informatës iu ka bashkangjitur edhe lista e akteve të miratuara në KK. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin. Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj se KPF, u

Njoftua

Me aktivitetin e Kuvendit të Komunës në vitin 2020 dhe i njëjti shkon në procedurë të KK për njoftim.

5. Informatë e DAK, për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2020-2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Numri i arsimtarëve të kualifikuar 371 nga 375 sa janë të angazhuar në dy nivelet arsimore, apo 99.03% është i madh, edhe notat mesatare është shumë e lartë në disa shkolla, mirëpo problemi është së, kur po vjen puna e Testit Pisa dhe të Provimit të Maturës, rezultatet e testeve po janë të dobëta, kjo nuk e di sesi justifikohet. Unë konsideroj se cilësia në arsim ende është shumë e dobët, përkundër faktit që janë bërë përpjekje në krijimin e kushteve infrastrukturore. Shkollat janë të mira me ngrohje, mirëpo duhet bërë ende për cilësinë në arsim. Tjetër, numri i mungesave të nxënësve dhe i arsimtarëve është i madh në disa shkolla fillore në terren. Çka është në pyetje aty, a është në pyetje puna e drejtorit apo mosfunksionimi i mirë i shkollës ? Në SHF "Naim Fashëri", ka mungesa krahasuar me SH "Emin Duraku" që është shkollë shumë e madh me numër të madh nxënësish dhe arsimtarësh apo në SHF "Jusuf Gërvalla dhe SHF "Qamil Ilazi" Unë mendoj se për rritjen e cilësisë në arsim duhet merren masa ndaj arsimtarëve.

z. Selim Reka, Të dhënat e paraqitura si në Informatë janë shumë reale, bëhet fjalë për një periudhë gjatë pandemisë, e cila periudhë nuk ka qenë e lehtë për askënd. Është sukses i madh që ka arritur me përfunduar një gjysmë vjetor i vitit shkollor, dy javë ditë kemi mbajtur mësim online. Mungesat dihen, disa janë si rezultat i izolimit të nxënësve dhe arsimtarëve. Kemi edhe shkolla të cilat nuk kanë mungesa. Në aspektin pozitiv duhet përmendur shkollat: “Agim Bajrami”, “Ali Asllani”, “ 7 Shtatori” por kjo nuk vlen për shkollat ”Naim Frashëri”, “Qamil Ilazi, Gjimnazin “Skënderbeu”, sepse kur numri i mungesave në këto shkolla pjesëtohet për arsimtarë del të jetë i madh. Në Gjimnazin “ Skënderbeu” numri i mungesave është si rezultat i pandemisë së disa arsimtarëve. Të suksesi, kemi qenë më dorëlibër për shkak të gjendjes së krijuar, edhe unë pajtohem se nuk jemi keq në shkollën e mesme “Skënderbeu” kur e dimë që testi i maturës ka qenë i mirë në nivel të Kosovës. Duhet punuar ende në krijimin e kushteve me të mira të shkollave me pajisje, në disa shkolla edhe pse disa pajisje janë bërë në disa shkolla, si pajisja me laptop, projektor etj., disa i kanë laptopët e tyre privat, mirëpo duhet bërë ende sa i përket furnizimit të shkollave me pajisje teknike e teknologjike.

z. Nexhat Loku, Nuk dua me replikuar Ekremin, por po bashkëbisedojmë së unë kam një përvojë të gjatë në arsim- 28 vjet. Të cilësia në arsim, rritja e notës mesatare në ciklin e ulët është si pasojë e vlerësimit së në klasën e parë të gjithë nxënësit i dinë numrat, shkronjat, mbledhjen dhe zbritjen, ndërkaq tek në klasën e tretë fillojnë me u ndarë nxënësit me të mirë dhe ata me të dobët. Tjetër, ligji për arsim nuk e lejon përsëritjen e nxënësve të klasës nga 1-5 pa marrëveshje të prindit dhe kjo është pasojë dhe po bartet të gjeneratat. Mungesat në SHF “Naim Frashëri” në Kotlinë, ndoshta do të tregoj edhe drejtori, ka qenë një arsimtare që nuk ka pasur mundësi me mbajtur mësim për shkaqe shëndetësore. Tani ka filluar me mbajtur mësimin, mirëpo mungesat e saja kanë ndikuar në rritjen e mungesave të arsimtarëve në këtë shkollë, sepse edhe pse është bërë zëvendësimi i kësaj arsimtareje, mungesat janë evidentuar.

z. Ekrem Kyçyku, unë kam qenë në 1981 në një shkollë të muzikës në Durrës, dhe një ligjërator që na i ka mbajtur drejtori i shkollës pati thënë së nga themelimi e deri sot asnjë orë nuk është e humbur në këtë shkollë. Unë e pyeta, si është e mundur kjo ? Ai me tha se kemi arsimtarë rezervë. Mendoj se edhe ne duhet me pasur arsimtarë rezervë për raste kur mungojnë arsimtarët, me qëllim të zëvendësimit të tyre.

z. Zahir Doda, Orët e mësimin janë mbajtur online, se na lejohen në këtë periudhë për shkak të pandemisë, por nuk janë regjistruar. Kjo ka reflektuar në numrin e mungesave. Të shkollat që janë më numër më të vogël të nxënësve dhe arsimtarëve, zëvendësimet është më vështirë me i gjetur. Informata është shumë e gjerë, por nuk ka pasur mundësi me qenë më e shkurtër, për shkak së është dashur me përfshirë edhe çështjen e Covid-19. Mungesat janë bërë kryesisht në zonat rurale dhe ka qenë problem zëvendësimi i tyre, sepse nuk i ke dy arsimtarë të matematikës apo të ngjashme në shkollat në zona rurale. Cilësia në arsim, është çështje që duhet debatuar të gjithë, pajtohem të gjithë për cilësinë në arsim, mirëpo kjo është gjendja reale.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo Informatë t’i përcillet Kuvendit të Komunës? Për me ia adresuar KK këtë Informatë u pajtuan njëzëri të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF u,

Njoftua

Informatën e DAK, për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2020-2021; dhe e njëjta i kalohet në procedurë të Kuvendit të Komunës.

6. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Materialin për këtë pikë e kemi marrë, ndërkaq kontributin në këtë plan do të japim në mbledhje të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Atëherë, meqë nuk ka kush diçka tjetër, konstatoj së KPF, u

Njoftua

Me Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021; dhe i njëjti i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim në formë informate.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora : 11:35. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 29 Janar 2021 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Kemal Mërseli